Komuna e Drenasit

PROFILI EKONOMIK

KOMUNA E DRENASIT

PROFILI EKONOMIK

2023

PROFILI EKONOMIK

Përmbajtja

HYRJE 4
FJALA E KRYETARIT TË KOMUNËS 5
Pozita gjeografike dhe klima 6
Misioni 8
Demografia 9
Buxheti Komunal 11
Punësim 12
Arsimi 14
Shëndetësia 16
Kulturë 17
Rinia 19
Sporti 20
Ekonomia 23
Siguria 25
Bujqësia 26
Uji dhe Ajri 29
Infrastruktura dhe Transporti 30
INFRASTRUKTURA HEKURUDHORE 31
TRANSPORTI NDËRURBAN 31
Turizmi 33
KONTAKTET 60

HYRJE

Profili Ekonomik i Komunës së Drenasit është i përgatitur me qëllim të prezantimit të potencialeve zhvillimore të komunës së Drenasit, duke prezantuar një përmbledhje të të dhënave që janë me interes për investitorë vendor dhe të huaj, pasi që në vete është një dokument informativ.

Informatat në këtë material janë një përmbledhje nga planet e ndryshme të Komunës, por duhet të merret parasysh që këto të dhëna janë gjithëpërfshirje e materialeve zhvillimore që komuna posedon.

Ky profil është hartuar nga Ekipi Komunal për hartimin e Profilit Ekonomik të Komunës se Drenasit, në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonmik dhe Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal.

Ekipi Punues

Anëtarët e Ekipit Komunal për hartimin e Profilit Ekonomik të Komunës së Drenasit:

Violeta Baleci - Koordinatore,

Albert Sinani - Anëtar,

Rinora Zymeri - Anëtare,

Arjanit Bala - Anëtar,

Bekim Morina - Anëtar

Lumturije Kiqina - Anëtare,

Agim Kastrati - Anëtar,

Afrim Prokshi - Anëtar,

Besart Bajrami - Anëtar,

Liridona Mulaku - Anëtare,

Ardian Gashi - Anëtar,

Safet Hoxha - Anëtar, dhe

Naxhije Leci Hajdari - Anëtare.

FJALA E KRYETARIT TË KOMUNËS

Qeverisja Komunale është e përkushtuar në vazhdimësi angazhohet për zhvillim të qëndrueshëm, përmes investimeve dhe projekteve në infrastrukturë, bujqësi, përkrahje të bizneseve të reja, arsim, shëndetësi, mirëqenie sociale, kulturë, rini e sport si dhe jemi të përkushtuar që në këto kushte, të bëjmë më të mirën për qytetarët dhe komunën tonë.

Profili Ekonomik i Komunës së Drenasit pasqyron potenciale të mira të resurseve humane, infrastrukturore, gjeografike, Ekonomike, të të bërit biznes.

Ky dokument ofron mundësi dhe hapësirë të mjaftueshëm për investitorët e interesuar që të investojnë në komunën tonë.

Ramiz Lladrovci

Kryetar i Komunës së Drenasit

Pozita gjeografike dhe klima

Komuna e Drenasit shtrihet në pjesën e Kosovës qendrore, në luginën e Drenicës, 32 km nga Prishtina, 110 km nga Shkupi dhe 230 km nga Tirana me një pozitë shumë të mirë gjeografike gjë që i mundëson asaj të jetë më afër çdo qendre të madhe industriale dhe tregtare që operon në qytetet e tjera të Kosovës, si Prishtinë, Pejë, Mitrovicë, Prizren etj.

Territori i saj, shtrihet në mes të Rrafshit të Kosovës dhe atij të Dukagjinit. Për nga sipërfaqja, Komuna e Drenasit përfshinë një sipërfaqe prej 275,63km2 me një lartësi mbidetare prej 575 m deri 1072 m.

Komuna e Drenasit rrethohet me Malet e Berishës në pjesën Jug− Perëndimore, Kasmaqit në pjesën perëndimore, Qyqavicës në pjesën Veriore, Goleshit dhe Lipovicës (Blinajës) në pjesën Jug−Lindore. Këto male shtrihen në të dy anët e Luginës së lumit Drenica. Drenasi kufizohet me Vushtrrinë dhe Obiliqin në verilindje, me Fushë Kosovën dhe Lipjanin në lindje, në jug me Suharekën, në jugperëndim me Klinën, dhe në veriperëndim me qytetin e Skenderajt.

E një rëndësie të veçantë për komunën e Drenasit është miniera dhe shkritorja e "Feronikelit" si dhe zona industriale Parku i biznesit 1 dhe 2 në Korroticë të Epërme (magjistrale Prishtinë – Pejë) këtë komunë kalojnë lumi Drenica dhe Vërbica, uji i të cilave shfrytëzohet për ujitjen e tokave bujqësore.

Nga aspekti i transportit rrugor, komuna e Drenasit lidhet përmes hekurudhës me Fushë Kosovë−Pejë-Prizren, Autostrada Vërmicë - Merdar si dhe Rruga Regjionale Caralevë – Bushat - Drenas-Skenderaj dhe rrugët regjionale R7 Autostrada Prishtinë − Prizren − Tiranë.

Rrugët ndërlidhëse dhe hekurudhat janë një mundësi e mirë për lëvizjen e shpejtë qytetarëve dhe mallrave. Aeroporti ndërkombëtar " Adem Jashari " gjendet 17 klm larg Drenasit. Kjo aftësi mundëson bizneset të kësaj komune të ofrojnë shërbime për pasagjerë, si dhe transport të mallrave.

Komuna e Drenasit ka klimë të mesme kontinentale me dimra të ftohtë dhe verë të ngrohtë, me temperaturë mesatare vjetore 10.6 ˚C, ku muaji më i ftohtë është janari me 0.8˚C, ndërsa muaji më i ngrohtë është korriku me 20.6˚C. Sasia mesatare e të reshurave është rreth 670 mm në vit, kurse lartësia mbidetare është prej 500−650m. Afërsisht gjysma e territorit të komunës së Drenasit gjendet në lartësinë mbidetare rreth 650m, lartësi kjo mjaft e përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë.

VENDBANIMET E KOMUNËS SË DRENASIT
VUSHTRRI
SKENDERAJ
Likoshan
Gradicë
Shtuticë
Polluzhë
Verboc
Gllanasellë
Godancë
OBILIQ
Tërstenik
Cikatovë e Vjetër
Dobrashec
Gllobar
Abri e Epërme
Cikatovë e Re
Gllogoc
Vasilevë
Baicë
Poklek
Domanek
GLLOGOC
Tërdec
Shtrubullovë
FUSHË KOSOVË
Korroticë e Epërme
KLINË
Vuçak
Krajkovë
Zabel i Poshtëm
Negroc
Zabel i Epërm
Sankoc
Llapushnik
Komoran
Fushticë e Epërme
Arllat
Kishnarekë
Fushticë e Poshtme
MALISHEVË
Nekoc
LIPJAN
N
Legjenda
Rrugë regjionale
Rrugë nacionale
Autoudhë
0 1 2 3 4 km
SUHAREKÃ‹
SHTIME

Misioni

"Të gjitha rrugët kalojnë nëpër Drenas", "Drenasi çelës i zhvillimit"

Në zemër të Kosovës, Drenasi me ekonomi të bazuar në zhvillim të qëndrueshëm rural, përkrahje të bizneseve, industrisë dhe infrastrukturës funksionale.

Banim e shërbime cilësore, ku qytetari është në qendër të vëmendjes e rinia e aftësuar profesionalisht;

Mjedis të qëndrueshëm e shfrytëzim racional të resurseve natyrore, promovim të trashëgimisë kulturore, turizmit e sportit.

Andaj, komuna e Drenasit është model i qëndrueshëm socio-ekonomik për një mirëqenie për të gjithë.

Demografia

Rritja e numrit të popullsisë ne Komunën e Drenasit është evidente nga të gjitha regjistrimet e kryera që nga viti 1948, 1953, 1961, 1971, 1981, 1991 dhe e fundit me vitin 2011. Në përgjithësi rezulton që Komuna e Drenasit ka pas rritje konstante të numrit të popullsisë për 42,354 banorë, nga 16,177 (regjistrimi ne vitin 1948) ne 58,531 (regjistrimi në vitin 2011). Siç mund të vërehet nga statistikat për 63 vitet e fundit nga viti 1948 deri në vitin 2011 ka rritje të popullsisë në komunën e Drenasit për 3.6 herë. Mosha e re 0 - 14 vjeç merr pjesë me 29.5 % në popullsinë e Drenasit, ndërsa grup-moshat 15 - 64 që është popullsi aktive (e aftë për punë) merr pjesë me 64.8%, kurse mosha 65 vjeç e më tepër kanë pjesëmarrje të vogël me rreth 5.6 % të popullsisë së përgjithshme. Në përgjithësi grup-moshat e popullsisë 15 – 64 vjeç dominojnë në popullatën e përgjithshme. Struktura gjinore e popullsisë ka karakteristikat e veta me dominim të gjinisë mashkullorë.

Dendësia e popullsisë - Bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, dendësia e popullsisë në komunën e Drenasit është rreth 212 banorë në 1 km², që është mbi mesataren në nivel vendi prej 165 banorë në 1 km². Në disa vendbanime që kanë numër më të madh të popullsisë edhe dendësia është shumë më e lartë dhe e kundërta në vendbanimet që kanë numër të vogël të popullsisë edhe dendësia është shumë më e vogël.

Madhësia e familjes - Madhësia mesatare e familjes në qytet del të jetë më e vogël se në vendbanimet tjera në komunë. Në qytet mesatarisht familjet i kanë nga 5.9 anëtarë, përderisa në nivel të komunës i kanë nga 6.7 anëtarë.

Struktura Organizative e Komunës së Drenasit



Buxheti Komunal

BUXHETI I KOMUNËS-TE HYRAT	2022
Granti qeveritar	15,502,612.00€
Të hyrat vetanake	1,209,986.00€
Të hyrat vetanake të bartura nga viti 2021	1,165,018.00€
Huaja	127,905.00
Granti i donatorëve të brendshme	2,213.00€
Granti i performancës	504,917.00€
Gjithsej	18,512,652.00€

SHPENZIMET E FONDEVE - PAGESAT	2022
Paga dhe shtesa	9,672,000.00€
Mallra dhe shërbime	2,143,770.00€
Shpenzime komunale	275,280.00€
Transfere dhe subvencione	413,000.00€
Shpenzime kapitale	4,999,000.00€
Tjera llog. e mirëbesimit	7,690.00€
Gjithsej	17,510,741.00€

Punësimi

Në Komunën e Drenasit janë të punësuar rreth 6,134 persona duke mos përfshirë numrin e saktë të të punësuarave në sektorin e ndërtimtarisë, për shkak se një pjesë e bizneseve të tilla nuk i dihet adresa e saktë. Vetëm në sektorin publik janë të punësuar 1,302 ndërsa ne sektorin privat kemi 4,832 të punësuar.

Administrata komunale: 184; 71 F dhe 113 M;

Institucion Arsimor: 938 prej tyre; 415 F dhe 523 M;

Institucion Shëndetësor: 180; 130 F dhe 50 M;



Ndërsa sa i përket të papunësuarave kemi 1,745 punëkërkues aktiv prej tyre 59% F DHE 41% M.



Arsimi

Organizimi i arsimit në Drenas realizohet në tri nivele:

- Arsimi parashkollor,
- Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët,
- Arsimi i mesëm i lartë.

Në nivelin arsimor 0 (arsimi parashkollor), funksionon 1 (një) institucion publik parashkollor, me vijueshmëri të rregullt janë të përfshirë 135 fëmijë .

Në Komunën e Drenasit funksionojnë 2 (dy) institucione private parashkollore.

Procesi edukativ arsimor organizohet në 33 institucione arsimore të arsimit publik para universitar.

1 institucion parashkollor publik, 30 institucione arsimore të arsimit fillor dhe mesëm të ulët (klasa përgatitore, klasa fillore dhe mesëm e ulët), numri i nxënësve 10393 në total. 2 institucione arsimore të arsimit mesëm të lartë, (klasa e dhjetë deri në dymbëdhjetë), numri i nxënësve 2231 në total.

Numri i stafit arsimor : 756

Edukatore : 61,

Mësimdhënës/e: 695.

Sa i përket digjitalizimit të shkollave :

- Tabela digjitale ne 30 shkolla (nga 2 tabela në secilën shkollë),
- Laptop – janë të pajisur gjysma e mësimdhënësve.

Aktivitetet nga Shkolla:

Shëndetësia

Shërbimet e kujdesit primar shëndetësorë për qytetarët e komunës së Drenasit ofrohen përmes Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare e cila përkujdeset për banoret e kësaj komune e cila ofron shërbime shëndetësore 24 orë si me poshtë:

QKMF-Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Drenas

- QMF –Qendra e Mjekësisë Familjare Komoran
- AMF- Qendra e Mjekësisë Familjare Tërstenik
- AMF –Qendra e Mjekësisë Familjare Arllat
- AMF –Ambulanta e Mjekësisë Familjare Nekoc
- AMF –Ambulanta e Mjekësisë Familjare Sankoc
- AMF –Ambulanta e Mjekësisë Familjare Vasilevë
- AMF –Ambulanta e Mjekësisë Familjare Baicë
- AMF –Ambulanta e Mjekësisë Familjare Gllanasellë
- AMF –Ambulanta e Mjekësisë Familjare Dobroshec
- AMF –Ambulanta e Mjekësisë Familjare Gradicë
- AMF –Ambulanta e Mjekësisë Familjare Abri e Ep.
- AMF –Ambulanta e Mjekësisë Familjare Tërdec

Gjithsej 13 institucione shëndetësore në të cilat ofrohen këto shërbime:

- Shërbimet e promovimit shëndetësorë, përfshirë informimin, komunikimin dhe edukimin ;
- Shërbimet e imunizimit dhe vaksinimit dhe shërbimet tjera parandaluese;
- Shërbimet esenciale kurative dhe ndërhyrje të vogla kirurgjike;
- Shërbime të kujdesit akut dhe urgjent;
- Shërbimet e kujdesit shëndetësor për sëmundjet kronike;
- Shërbimet e kujdesit shëndetësor për fëmijë, adoleshentë dhe të rinjtë;
- Shërbimet e kujdesit ante/peri dhe post natal;
- Shërbimet e shëndetit oral prevenues;
- Shërbimet e shëndetit mendor;
- Shpërndarjen e barërave nga lista esenciale
- Shërbimet e vizitave shtëpiake përfshirë këtu shërbimet e kujdesit të nënave dhe fëmijëve deri në moshën tre vjeçare,
- kujdesin terminal/paliativ;

Kulturë

Komuna e Drenasit ka traditë të gjatë në kultivimin dhe zhvillimin e kulturës dhe artit. Drenasi njihet për aktivitete të ndryshme kulturore-artistike, që organizohen nga të rinjtë e kësaj komune.

Në komunën e Drenasit funksionon Shtëpia e Kulturës me një sip. 410m2 me 306 ulëse në të cilën organizohen manifestime të ndryshme kulturore si: manifestime përkujtimore, shfaqje teatrale dhe koncerte të ndryshme, po ashtu funksionon Teatri i Qytetit dhe tri Shoqëri Kulturo-artistike dhe dy institucione të rëndësishme Arkivi dhe Bibliotekat.

Në komunën e Drenasit funksionon Arkivi historik i komunës me gjithsejtë 48 fonde arkivore, dhe 4 biblioteka, në Drenas, Tërstenikë, Komoran, Arllat me një fond prej 25,381 ekzemplar dhe 9,318 tituj, bibliotekat e qytetit kanë një kapacitet të mjaftueshëm të librave që janë në dispozicion të lexuesve.

Në komunën e Drenasit veprojnë tri shoqëri kulturo−artistike: ShKA “Panajot Kanaqi", ShKA “Shotë Galica" dhe ShKA “Ymer Alushani" . Ndër aktivitetet më të rëndësishme kulturore që tradicionalisht organizohen në Drenas, vlen të përmendën: “Ditët e Mërgatës”; Sofra poetike “Ymer Elshani”; Revista Folklorike Burimore Shqiptare; Festivali “Ditët e humorit Drenasi”, etj.

SHKA-at janë pjesëmarrës në çdo aktivitet duke sjellë një laramani të këngëve dhe valleve të bukura të trashëgimisë shpirtërore tradicionale dhe duke ruajtur me fanatizëm vlerat kulturore shqiptare.

Në kuadër të kulturës organizohen festivale si : RFBSH (Revista e Folklorit Burimor Shqiptar), Festivali i shkollave, Festivali i Humorit “Humoriada”, Muaji i Mërgatës, manifestimet për nderë të 17 Shkurtit, 14 Qershorit “Ditës së Çlirimit të Drenasit”, Festat e Nëntorit, Kongresi i Manastirit, Sofra Poetike “Ymer Elshani” , promovime librash dhe orë letrare në bashkëpunim me karvanin e shkrimtarëve, takime letrare për nderë të poetit Rifat Kukaj.

Në kuadër të kulturës janë Shoqëritë Kulturore Artistike SHKA” Shotë Galica”

Ansambili ’’Shqipet e Drenicës”

Rinia

Rinia në komunën e Drenasit është mjaft mirë e organizuar me aktivitete që kanë qëllim emancipimin, përmirësimin dhe vetëdijesimin e rinisë dhe qytetarëve në përgjithësi.

Ne komunën e Drenasit ekzistojnë klube sportive si:

Klube që marrin pjesë në garat e organizuara nga Federata e Futbollit të Kosovës.

Klubet kanë pasur suksese dhe kanë fituar medalje të arta në nivel vendi dhe medalje ndërkombëtare.

Edhe volejbolli si sport është mjaft i përhapur, për të cilin organizohen gara të ndryshme për të dy gjinitë pasi që interesimi për të është mjaftë i madh.

Në dispozicion të Rinisë është Qendra Rinore, një objekt mjaftë atraktive dhe funksional.

Aktivitetet kryesore rinore:

- Muaji Rinor 14 Shtator
- Edukime jo formale dhe vetëdijesime të rinjve rreth dukurive negative
- Ekspozita të ndryshme
- Përgatitjet për revistën rinore Realiteti

Aktivitete rinore

Sporti

Në komunën e Drenasit veprojnë një numër i konsiderueshëm i klubeve sportive (17 klube) klubet sportive me suksese të arritura ne nivel të Kosovës janë Klubi i Futbollit "Feronikeli 74", KH "Drenica", Futsal Klub " Liqeni ", këto klube kanë marr pjesë në garat e organizuara nga Federatat Kosovës brenda dhe jashtë Kosovës ku kanë arritur suksese të shkëlqyera. Aktivitetet të gjitha klubet i zhvillojnë në objekte sportive.

Drenasi disponon një infrastrukturë të mirë sportive si: Stadiumi i Futbollit ,, Rexhep Rexhepi'', Stadiumi Sintetik- Drenas, Palestra Sportive ,, Hysni Jetullahu''- Drenas, por janë në shërbim edhe 5 (pesë) fusha sportive në Bashki lokale, që ofrojnë një mundësi të mirë për talent të rinj.

Ndër aktivitetet më të rëndësishme sportive të cilat organizohen në komunën e Drenasit, vlen të përmendën: Turnire për nder të festave kombëtare dhe shtetërore, Krosi Komunal Pranverorë– Vjeshtorë, garat e pioniereve dhe të rinisë shkollore, manifestimi për zgjedhjen e sportistit të vitit, turnir memorial–tradicional në futboll, etj. Po ashtu, çdo vit klubet sportive subvencionohen nga Komuna e Drenasit. Komuna e Drenasit vazhdimisht u ofron ndihmë

klubeve sportive përmes këshillimeve profesionale, subvencionimit të kultivimit dhe licencimit të klubeve, dhe krijimit të hapësirave të mjaftueshme për stërvitje dhe zhvillim të ndeshjeve. Për më tepër, në vazhdimësi ka përkrahur financiarisht klubet dhe shoqatat sportive.

Klubu i Futsallit „Liqeni''

F.C. ,,Feronikeli''

Ekonomia

Komuna e Drenasit ka potencial për zhvillim ekonomik duke u bazuar në resurset, kapacitetet dhe pozitën qendrore që ka komuna e Drenasit në Kosovë. Potencialet kryesore mbi të cilat mbështetet zhvillimi ekonomik dhe gjenerimi i punësimit janë industria, toka bujqësore dhe bizneset (NVM-të).

Aktivizimi i Feronikelit, në vitin 1984, në masë të konsiderueshme ndikoi që brenda
një kohë të relativisht të shkurtër të arrihej gati te mesatarja e zhvillimit ekonomik të Kosovës.



Në komunën e Drenasit zhvillimi i sektorit privat që nga paslufta kryesisht është përkrahur nga donatorët dhe projektet ndërkombëtare si dhe komuna, megjithatë roli i bizneseve, e posaçërisht i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) ka qenë i lartë në zhvillimin ekonomik lokal, sidomos në krijimin e vendeve të punës.

Komuna e Drenasit numëron gjithsej 2154 biznese aktive, prej tyre 730 SH.P.K. dhe 1424 B.I.

Pasqyra e bizneseve sipas shpërndarjes, punësimit dhe qarkullimit në %.



Resurset minerale ne Komunën e Drenasit

Drenasit po ashtu është shumë i pasur me resurse tokësore dhe nëntokësore e cila posedon resurse energjetike dhe metalore.

Resurse energjetike - janë resurset e qymyrit qe shtrihen ne komunën e Drenasit i përkasin Basenit të Drenicës që shtrihet me një sipërfaqe 5.1 km^2 në mes të basenit të Kosovës në lindje dhe basenit të "Dukagjinit" në perëndim me një gjatësi të përgjithshme rreth 30 km dhe gjerësi maksimale rreth 10 km.

Fusha e Drenasit përfshin fshatrat: Gllobar (qymyrit të kualitetit ksilit, sedimente liqenore të Pliocenit të poshtëm (ekuivalent të Pontianit) pastaj në Poklek dhe Komoran.

Ndërsa **resurse metalore** të cilat janë: Nikeli, Hekuri, Kromi.

Nikeli - Hulumtimet kanë zbuluar vendburimin në Çikatovë të vjeter afër Drenasit. Vendburimi silikat i nikelit "Çikatova e Vjetër" gjendet në regjionin e masivit peridotit të Dobroshevcit komuna e Drenasit. Ky vendburim dhe mineralizimet tjera silikate të Ni dhe Co i takojnë pjesës qendrore të basenit të Drenicës. Rajoni i Çikatovës së Vjetër i takon pjesës qendrore të basenit Drenicës dhe në drejtim të lindjes dhe perëndimit janë të rrethuara me fusha të gjëra të cilat shtrihen në drejtim të Gllanasellës dhe Gllobarit po ashtu Miniera e nikelit "Çikatova e Vjetër" përbëhet nga dy vendburime: Dushkaja dhe Suka dhe vendburimi në "Dushkaja" e më vonë edhe "Suka" janë has paraqitje të xeheroreve të nikelit silikat në: (Likoshan, Krajkovë-Domanek, Llapushnik, Krojmirë dhe Nekovc etj.) në regjionin e Drenasit. Lidhjet e kumunikacionit janë të volitshme ngase në pjesën lindore të Çikatovës së Vjetër kalon hekurudha Fushë Kosovë-Pejë në largësi prej 150-1000 m. Nga Çikatova e Vjetër rruga e asfaltuar, në largësi prej 2 km, lidhet me stacioni hekurudhor dhe me qendrën e qytetit të Drenasit dhe me Prishtinën.

Hekuri - Në Drenas kemi disa paraqitje të hekurit oolitik me përbërja te hekur-nikelit qe sillet nga 30-35% Fe, 1.0-1.5% Ni, dhe 2.5 -3.5% Cr2O3. Ne lokacionet : Trstenik, Vrbovc dhe Gradinë.

Kromi - Sipas të dhënave sasia e tërësishme e kromiteve të shfrytëzuara në Masivin e Dobrashevcit, Komuna e Drenasit është 2.000 t. Hulumtimet në zonën e Dobroshevcit janë kryer vetëm në paraqitjet sipërfaqësore dhe te dhënat kryesore janë te bazuara ne shfrytëzimin e deritanishëm nga këto nxjerrja sipërfaqësore dhe ato me thellësi të vogël, kurse kontinuiteti i mineralizimit në thellësi ka mbet i panjohur.

Siguria

Siguria në komunën e Drenasit është në nivelin e duhur, për faktin se kemi pak raste që lajmërohen nga policia. Kjo është arritur falë bashkëpunimit dhe angazhimit të komunës për rritjen e sigurisë në qytet dhe në të gjitha vendbanimet e komunë se Drenasit.

Në fushën e sigurisë se lëvizjes, në si komunë kemi bërë vendosjen e ndriçimit publik po thuajse në 70% të fshatrave të Komunës dhe Qendrës se qytetit, ndërsa nga mundësia e parandalimit nga dukurit negative, kemi të vendosura 32 kamera në rrugët e qendrës së qytetit dhe në Komoran, të cilat monitorohen 24/7h nga Policia (Stacioni i Policisë në Drenas).

Për evitim nga rreziqet e qenve endacak, komuna ka të angazhuar një operator ekonomik për trajtimin e qeneve endacak, ku për të gjitha rastet njoftohet ky operator dhe pastaj vepron komfor marrëveshjes se lidhur në mes komunës dhe OE.

Në nivel Komunal është edhe Komiteti për Siguri në Bashkësi, ku mban takime të rregullta dhe shtjellon qeshjet që kanë nevojë për zgjidhje dhe adresohen tek Drejtoritë relevante.

Bujqësia

Territorin e komunës së Drenasit e përshkon një klimë e butë kontinentale e cila reflekton që toka të jetë shumë pjellore për zhvillimin e degëve bujqësore në përgjithësi.

Komuna e Drenasit ka në shfrytëzim 12,929 ha tokë bujqësore e cila është e kategorizuar sipas hektarëve dhe kategorisë taksore, tokë e punueshme, serra, livadhe, pemishte, vreshta, djerrina, kullota, pyje, si dhe kategori të tjera dhe nga kjo sipërfaqe bujqësore 5600 hektarë janë nën sisteme ujitjeje. Pjesa e rrafshët e komunës e sidomos lugina përgjatë lumit "Drenica" është tokë me potenciale të mundshme për zhvillimin e bujqësisë intensive. Lumi "Drenica", kanali i sistemit ujitës Ibër - Lepenci si dhe lumi Verboc janë faktorë të rëndësishëm në zhvillimin e bujqësisë.

Bujqësia ka qenë dhe vazhdon të jetë një prej faktorëve shumë i rëndësishëm në zhvillim ekonomik të komunës.

Aktivitetet në fushën e bujqësisë janë të fokusuara kryesisht në kultivimin e grurit, misrit, pemëve, perimeve si kultura bujqësore kryesore.

Përveç kësaj, sektori i blegtorisë dhe bletarisë po ashtu ka potencial për zhvillim, vërehet një tendencë e zhvillimit të bujqësisë intensive-serrave.



Uji dhe Ajri

Ambienti - Sa i përket cilësisë së tokës, përkatësisht përshtatshmërisë, Drenasi karakterizohet me tokë cilësore.

Klima kontinentale me të reshura mesatare krijojnë kushte shumë të volitshme për zhvillimin e bujqësisë. Rajoni ka një klimë të mesme kontinentale me dimra të ftohtë dhe verë të ngrohtë.

Temperatura mesatare vjetore është 10.6 °C, ku muaji më i ftohtë është janari me 0.8°C, kurse muaji më i ngrohtë është korriku me 20.6°C.

Relievi - Lartësia mbidetare është prej 500-650m. Rreth 46% e sipërfaqes së territorit të komunës së Drenasit gjendet në lartësinë mbidetare rreth 650m, lartësi kjo që është njëra ndër më të përshtatshmet për zhvillimin e prodhimtarisë bujqësore, ndërsa pika më e lartë është 1072m.

Parku i Pishave

Infrastruktura dhe Transporti

Komuna e Drenasit është e pozicionuar në qendër të Republikës se Kosovës, ngjashëm qyteti i Drenasit është i pozicionuar në qendër të shtrirjes hapësinore të komunës. Kjo përparësi i mundëson që të gjitha vendbanimeve në komunë të kenë lidhje të afërta rrugore me qytet, si dhe i jep përparësi komunës së Drenasit përmes lidhjeve të mira me të gjitha komunat në Kosovë.

Infrastruktura e vendosur mirë dhe transporti i mirë janë joshëse për investitorët.

Sipas regjistrit të rrugëve në nivel komunal, gjatësia e përgjithshme e rrjetit rrugor është 570.20km, prej të cilave 512.5km janë rrugë lokale, 35.4km janë rrugë regjionale, 19.53km janë rrugë nacionale, si dhe 2.78km janë auto udhë.

Infrastruktura rrugore në komunë është kryesisht e modelit me dy korsi, përveç **rrugës nacionale Prishtinë-Pejë** në gjatësi prej 19.53km, si dhe segmentit të shkurtë të **autoudhës Rruga e Kombit** me gjatësi 2.78km të cilat janë me 4 korsi. Rruga nacionale Prishtinë-Pejë, segmenti i auto udhës, rrugët tjera nacionale dhe regjionale shërbejnë si nyje kyçe për transport rrugor dhe gjendja e tyre konsiderohet të jetë kryesisht e mirë.

Autostrada Prishtinë – Drenas – Pejë - Tiranë

Në total **rrjeti rrugor lokal** është në gjatësi prej 512.5 km, rrjeti rrugor lokal i komunës se Drenasit lidhet me rrjetin e rrugëve nacionale përmes rrugëve Prishtinë-Pejë dhe asaj regjionale Mitrovicë-Lipjan. **Kryqëzimet kryesore** në komunë janë në Komoran dhe në hyrje të Drenasit tek rrethi.

Rrugët lokale ofrojnë lidhje shumë të mirë në mes të vendbanimeve në zona rurale si dhe me qytetin e Drenasit.

INFRASTRUKTURA HEKURUDHORE

Komuna e Drenasit e ka rrjetin hekurudhor me pesë terminale hekurudhore në Dobroshec, Drenas, Damanek, Baicë dhe Tërdec. Në shërbim të udhëtarëve janë 3 operime ditore në linjën Fushë Kosovë – Drenas - Pejë. Infrastruktura hekurudhore është nën menaxhim të kompanisë publike 'TRAINKOS'. Janë të vendosura tri laura (-kufizuese apo barriere) , një në qytet, Në kryqëzimin e hekurudhës me rrugën regjionale Drenas Komoran , një në Rrugën tek lagja Qorri dhe një Çikatovë të Re , ndërsa në vendbanimet e tjera që kanë rrugë që kryqëzohen me hekurudhë janë të pajisura me shenjëzim adekuat në 13 vend kryqëzime të rrugëve me hekurudha, që është përgjegjësi e komunës për shenjëzim horizontal dhe vertikal, dhe janë të mirëmbajtura sipas nevojës.

TRANSPORTI NDËRURBAN

Transporti ndërurban i udhëtarëve ka për shërbim një stacion të autobusëve me 12 vend parkingje për autobus si dhe 24 vend parkingje për taksi. Linjat e autobusëve e lidhin Drenasin me Shqipërinë, qytetet Prishtinë dhe Skenderaj, si dhe me të gjitha vendbanimet e Drenasit në drejtimet vajtje dhe ardhje. Frekuentimi bëhet kryesisht me autobus por në disa fshatra edhe me minibus. Komuna ka investuar në rregullimin vend ndaljeve për autobus edhe vendosjen e mbulojave të vend ndaljeve ku është rritur siguria e lëvizjes në komunikacion rrugor për qytetarët e komunës se Drenasit

Qasja në shërbime bazike

Sa i përket qasjes në shërbime bazike, përfshirja e qytetarëve në sistemin e ujit të pijshëm është 59.19%, në rrjetin e kanalizimit është 99.81% ndërsa sa i përket rrjetit për energji elektrike dhe rrjetit të internetit është i shtrirë në gjithë Komunën e Drenasit.

Turizmi

Komuna e Drenasit karakterizohet me mundësi të shumta të zhvillimit të turizmit kulturor dhe rural.

Vendet me potencial të lartë turistik dhe atraktive për zhvillimin e turizmit si Kalaja e Verbovcit, Liqeni i Vasilevës, lumenjtë Drenica dhe Verbica, Gryka e “Gurit të Plakës”.

Guri i Plakës.



Liqeni i Vasilevës.

Guri i Gradinës, Kalaja e Vuçakut, Pishat e Gllobarit etj., paraqesin disa nga burimet e rëndësishme për zhvillimin e turizmit në Drenas.

Pa ashtu në territorin e Drenasit ekzistojnë edhe disa shpella si: Shpella e Peshterrit në Nekovc, Shpella e Kizharekës, Shpella e Kokilit në Vërboc, Shpella e Baicës dhe Shpella e Gllanasellës.

Shpella e Kishnarekës.

Komuna e Drenasit ka një trashëgimi mjaft të pasur kulturore me objekte ose monumente të trashëgimisë kulturore, të periudhave të ndryshme historike si Kalaja e Verbovcit, Kalaja e Vuçakut etj.

Viset malore siç janë Çyçavica, Vargmalet e Berishës e Kosmaçit e rrisin potencialin konkurrues për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në komunën e Drenasit.

Kalaja e Vuçakut

Pronat publike për shfrytëzim;

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna Gllogoc
Zyra e Kryetarit

Nr. 01- 463/02-571/1 **dt.** 22.11 **.2023**

Paraqitja tabelare e listës se veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës së Drenasit, të cilat planifikohen të ipen në shfrytëzim afatgjatë gjatë vitit 2024

Nr.	Ngastra Kadastrale	Sipërfaqja (m²)	Zona Kadastrale	DESTINIMI (PZHK-Harta Zonale)
	1981/0	*3263*	Komoran	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore
1				
		6963	Komoran	Shërbim Tre tar Komercial, Ndërtimore
2				g

3	244/4	1893	Komoran	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore
4	244/5	1547	Komoran	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore
5	1980/0	2003	Komoran	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore

6	382-0	358246	Komoran	Zonë bujë ësore (shfrytëzime tërësisht e lejuara në ërsh	
7	311-1	75318	Komoran	Zonë bujë ësore (shfrytëzime tërësisht e lejuara në ërsh	
8	438 4 /	2559	Gllobar	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore	

9	438/5	1838	Gllobar	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore
10	12-0	2794	Gllobar	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
11	Pjesë e parcelës 671-0	150000	Baicë	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)

		8454	Gllobar	Zonë Bu˙ ësore (shfrytëzime t˙era të le˙uara në ërshtatshmëri me HZK)
12	13-0			
13	Pjesë e parcelës 67-0	15000	Gllobar	Zonë Ndërtimore (Banim i ulët rural)
14	Pjesë e parcelës 81-0	4000	Gllobar	

15	Pjesë e parcelës 41-0	16500	Gllobar	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK) dhe Zonë Ndërtimore (Banim i ulët rural)
16	Pjesë e parcelës 1963-0	103309	Tërstenik	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
17	*34/0*	*8128*	Korroticë e Epërme	Zonë Industriale (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)

18	878-5	4259	Gllogoc	Banim i lartë (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
19	758-1	1852	Gllogoc	Banim i lartë (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
20	743/30	8510	Gllogoc	Banim i lartë (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)

21	*1032-2*	*5661*	*Gllogoc*	Banim i larë (shf[illegible]ëzimi [illegible] uara në [illegible] ndërtesën me HZK)
22	Pjesë e parcelës 768 2	2044	Gllogoc	Banim i larë (shfrytëzimi [illegible] i [illegible] ndërtesën me HZK)
23	Pjesë e parcelës 767 2	2500	Gllogoc	Banim i larë (shfrytëzimi [illegible] ndërtesën me HZK)

24	Pjesë e parcelës 767/5	1639	Gllogoc	Banim i lartë (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
25	Pjesë e parcelës 726/17	15410	Gllogoc	Banim i lartë (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
26	Pjesë e parcelës 726/15	5000	Gllogoc	Banim i lartë (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)

27	Pjesë e parcelës 245-0	5000	Gllogoc	Banim i ulët (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
28	Pjesë e parcelës	400	Gllogoc	Banim i Ulët (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
29	Pjesë e parcelës 768-1	1970	Gllogoc	Banim i lartë (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)

30	Pjesë e parcelës 77-1	727119	Fushticë e Epërme	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
31	Pjesë e parcelës 2652/4	3232	Arllat	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore, Industri
32	Pjesë e parcelës 2529-3		Arllat	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore, Industri

33	2360-0	23446	Arllat	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
34	276-0	2303	Arllat	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore, Industri
35	Pjesë e parcelës 144/0	21241	Polluzhë	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore, Industri

36	*140/3*	*19244*	Çikatovë e Re	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore, Industri
37	126-2	2000	Çikatovë e Re	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore, Industri
38	881-0	99648	Çikatovë e Vjetër	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)

39	875-0	66130	Çikatovë e Vjetër	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
40	1-1	172471	Fushticë e Poshtme	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
41	872-2	366190	Kishnarekë	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)

42	883-0	74447	Kishnarekë	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
43	885-0	3346	Kishnarekë	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
44	886-0	3322	Kishnarekë	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)

45	331-0	142958	Gllanasellë	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
46	351-0	49889	Gllanasellë	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
47	295-6	50000	Sankoc	Zonë banimi i ulët (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)

48	295-7	400000	Sankoc	Zonë banimi i ulët (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
49	Pjesë e parcelës 295-19	2972645	Sankoc	Zonë banimi i ulët (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
50	Pjesë e parcelës 556-0	90000	Likoshan	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)

51	568-0	75310	Likoshan	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
52	573-0	62399	Likoshan	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
53	572-0	53389	Likoshan	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)

54	575-0	137655	Likoshan	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
55	19-0	179047	Gllanasellë	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
56	504-0	2265	Korroticë e Poshtme	Zonë banimi i ulët (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)

57	Pjesë e parcelës 716-2	641500	Korroticë e Poshtme	Zonë banimi i ulët (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
58	208-1	13447	Korroticë e Epërme	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore, Zonë banimi i ulët
59	Pjesë e parcelës 913-0	92000	Krajkovë	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)

60	Pjesë e parcelës 848-0	130000	Krajkovë	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
61	999-0	67275	Llapushnik	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
62	559-0	28119	Negroc	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)

63	539-0	109084	Negroc	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
64	1195-0	18821	Negroc	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
65	Pjesë e parcelës 2048-0	61902	Abri e Epërme	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)

66	Pjesë e parcelës 1817-1	70000	Abri e Epërme	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
67	Pjesë e parcelës 349-0	74500	Domanek	Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)
68	Pjesë e parcelës 780-2	8000	Tërstenik	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore, Bujqësore

69	4-133	1059	Komoran	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore
70	395-17	39565	Sankoc	Zonë banimi i ulët (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)

Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

KONTAKTET

Adresa: Rr. "Fehmi e Xhevë Lladrovci", Drenas

Kodi postal: 13000

Tel: 038 200 40 800

E-mail: komuna.drenas@rks-gov.net

Thirrje pa pagesë: 080013050

SEKTORËT DHE NJËSITË

Sektori për Emergjencë
Shef i Sektorit: **Afrim Prokshi**
Tel: **044 170 784**

Njësia për Komunitete dhe Kthim
Udhëheqës: **Afije Veseli**
Tel: **044 896 460**

Zyra për Barazi Gjinore
Koordinatore: **Zahrije Podrimqaku**
Tel: **049-977-973**

Shërbimi i Zjarrfikësve
Shef i shërbimit: **Afrim Gjeli**
Tel: **049-978-446**

Ndërmarrja Publike e Ujit
Drejtor: Ismet Baliu
Tel: **044 170 647**

Zyra për Marrëdhënie me Publikun
Udhëheqës: **Bekim Dobra**
Tel: **049 977 799**

Integrime Evropiane
Udhëheqës: **Ibrahim Hajdari**
Tel: **044 175 597**

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
Koordinatore: **Laureta Thaqi**
Tel: **049-642-992**

Stacioni Policor
Komandanti: **Driton Morina**
Tel: **045 701 702**

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
Drejtor: **Ismet Bogiqi**
Tel: **044 170 695**

Ndërmarrja Publike për Menaxhimin e Mbeturinave
Drejtor: **Kastriot Berisha**
*Tel: **045 252 422***